

Letër familjes

I dashur nxënës, të dashur familjarë,

Këtë vit matematikor kaq interesant do ta mbyllim duke studiuar probabilitetin. Probabiliteti na thotë se ka fare pak gjasë që ju të fitoni çmimin e madh të një llotarie shtetërore. Zëreni se ju duhet të zgjidhni gjashtë numra të ndryshëm, nga 1 në 54. Për të fituar çmimin e madh, të gjashtë numrat duhet t'u përgjigjen atyre që janë përzgjedhur gjatë një heqjeje rastësore. Probabiliteti për të fituar është vetëm 1 në 25.827.165 ose 0,00000004.

Probabiliteti që diçka të ndodhë shprehet me një numër midis 0 dhe 1.

- Probabilitet 0 do të thotë se një ngjarje nuk ka gjasë të ndodhë. (Kështu, probabiliteti për të fituar në llotarinë shtetërore është shumë afër 0.)
- Probabiliteti 1 do të thotë se ngjarja pa tjetër do të ndodhë.
- Një probabilitet $\frac{1}{2}$ ose 50% do të thotë se diçka ka po aq gjasë që të ndodhë sa edhe të mos ndodhë.

Për shembull, në rast se një parashikues moti thotë se probabiliteti që nesër do të bjerë shi është 90%, është një ide e mirë që të merrni ombrellën me vete, edhe pse mund të mos bjerë shi. Në rast se përkundrazi, probabiliteti i shiut është 10%, ka fare pak të ngjarë që kjo të ndodhë.

Në këtë kapitull, do të përdorni arsyetimin matematik për të llogaritur probabilitetet në situata të thjeshta, si përshebull, gjatë hedhjes së monedhave ose shortit me emra. Do të bëni edhe disa eksperimente, gjatë të cilave do të hidhni monedha ose short me emra, dhe pastaj do t'i krahasoni rezultatet konkrete me probabilitetet e llogaritura.

Fjalor Do të njiheni me këto terma të rinj:

gjasë e njëllajtë
probabilitet teorik
probabilitet eksperimental

simulim
probabilitet

Çfarë mund të bëni në shtëpi?

Kërkoni situata të përditshme që kanë të bëjnë me probabilitete, si për shembull gjasat që të bjerë shi ose shanset në lojra sportive. Mund ta nxitni fëmijën të kërkojë më tej, duke luajtur me të lojra probabiliteti. Thojini t'ju mësojë lojrat që kemi luajtur në klasë dhe kërkojini t'ju shpjegojë se ç'rol luan probabiliteti në këtë apo atë lojë.

